



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2018:038752

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05758952

P.nr.403/19

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NË KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me bashkëpunëtorin profesional Ismajl Kuçi, në lëndën penale , në procedurën e veqar ndaj të pandehurit H.K nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale në bashkryerje, Keqpërdorim I besimit nga neni 342 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.98-14/18 të datës 12.01.2018 jashtë shqyrtimit gjyqësor, më datë 30.05.2024 mori këtë

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit, H.K nga fsh...-Kaçanik, I lindur me dt.... nga I ati H... dhe e ëma H..., e gjinisë Q..., shqiptar, shtetas I Rep. së Kosovës, I pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, I pa punë, I gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal:...,

HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj me nr. PP.nr.98-4/18 e datës 12.01.2018, për shkak të veprës penale në bashkryerje, Keqpërdorim I besimit nga neni 342 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se është shkaktuar ndalesa absolute për ndjekje penale.

E dëmtuara, ... me seli në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bijnë në ngarkim të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka ngrit aktakuzën PP.nr.98-4/18 të datës 12.01.2018 kundër të pandehurit H.K nga fsh...-Kaçanik, për shkak të veprës penale në bashkryerje, Keqpërdorim I besimit nga neni 342 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata konstatoi se vepra penale në bashkryerje, Keqpërdorim I besimit nga neni 342 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është kryer mes dt.20/21.11.2017.

Sipas nenit 106 par.1 nënpar.1.5 të KPK-së, (04/L-082), për veprën penale në bashkryerje, Keqpërdorim I besimit nga neni 342 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, është paraparë afati i parashkrimit prej 3 vite, ndërkaq sipas nenit 107 par.8 të KPK-së, është paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit.

Prandaj në bazë të kësaj, gjykata konstaton se për veprën penale në bashkryerje, Keqpërdorim I besimit nga neni 342 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, me dt. 21.11.2017, ka arritur afati i parashkrimit.

Meqë nga dita e kryerjes së veprës penale dhe ditës së marrjes së këtij aktvendimi kanë kaluar më tepër se gjashtë vite, gjykata ka gjetur se ekzistojnë shkaqet për hudhjen e aktakuzës sepse është shkaktuar parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në contest civil u mor konfor nenit 462 par.2 të KPP-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK
P.nr.403/19 datë 30.05.2024

Bashkpunëtori profesional
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërm